



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ___/___/2023

VENDIM

Nr. 11, datë 31.03.2023

PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT PARAPRAK DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM,
PËR FILLIMIN E NEGOCIATAVE DHE HARTIMIN E
PROJEKTMARRËVESHJES SË LINJËS SË KREDISË NË GATISHMËRI,
NDËRMJET AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE BANKËS
EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH), PËR
PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE LIGJORE TË AGJENCISË, NË RAST TË
NJË NGJARJEJE SIGURIMI

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja “n”, neni 52, pika 1, shkronja “nj”, të nenit 53, pika 6, shkronja “b”, të nenit 58, pika 1, shkronja “c”, të nenit 60 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, shkronja “b” dhe shkronja “r”, pika “i” dhe pika “iv” të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 5, pika 2, shkronja “b” të rregullores të Këshillit Drejtues nr. 20, datë 25.09.2017 “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të nenit 18, pika 2 të rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhënien e autorizimit paraprak Drejtorit të Përgjithshëm, për fillimin e negociatave dhe hartimin e projekt marrëveshjes së linjës së kredisë në gatishmëri, ndërmjet Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për përmbushjen e detyrimeve ligjore të Agjencisë, në rast të një ngjarjeje sigurimi.





2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm dhe njësitë organizative të Agjencisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

